

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.108/2013, “Për të huajt”” i ndryshuar.
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Brendshme
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozimi i Direktives dhe i brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Direktiva 2004/38 / KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 29 prill 2004 mbi të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të Shteteve Anëtare.
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	“Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 dhe plani i saj i veprimit” i miratuar me vendimin nr.818, datë 26.11.2014 të Këshillit të Ministrave
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	19.09.2019 deri ne date 16.10.2019
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	16.09.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po, 18.11.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019-MB/MFE/MEPJ/1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Alma Emini alma.mehmeti@mb.gov.al Shpresa Peza (Shahaj) shpresa.shahaj@mfa.gov.al Etleva Dyrmyshi etleva.dyrmyshi@financa.gov.al

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë referuar legjislacionit për të huajt përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë jashtë vendit, lëshojnë viza për shtetasit e huaj sipas motivit të ardhjes së tyre në Shqipëri. Për marrjen e vizës i huaji duhet te paraqitet në përfaqësinë diplomatike që mbulon shtetin nga ai vjen. Për shtete ku RSh nuk ka përfaqësi diplomatike, i huaji duhet të udhëtojë në një shtet tjetër ku Republika e Shqipërisë ka përfaqësi dhe që mbulon shtetin nga ai vjen. Kjo procedure ka rezultuar problematike për aplikuesit, për faktin se shumë vende, si p.sh. Filipinet, që për të marrë

vizën për të hyrë në territorin e RSH, duhet të marrin vizë italiane, pasi Ambasada që lëshon vizën për këtë vend është Ambasada e RSH-së në Itali, Romë.

Një tjetër problem i identifikuar, lidhet me kohën e gjatë dhe procedurën që përcakton ligji 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, për pajisjen me leje pune të shtetasve të huaj që duan të punojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ligji përcakton një afat kohor dhe procedurë për lëshimin e lejes së punës që mund të shkojë deri në 60 ditë, duke penguar plotësimin e nevojave për fuqi punëtore të huaj të punëdhënësve.

Gjithashtu, ky ligj nuk ofron përparësi për hyrjen e punonjësve të teknologjisë së informacionit me shtetësi të huaj në tregun e punës në vend. Kjo kategori punonjësish vlerësohet si një kategori për të cilën ka nevojë tregu i punës në vend dhe që duhet të gëzojë përparësi dhe të mos ketë kufizime sic janë kuotat ose detyrimi për të shpallur më parë vendin vakant parashikuar përkatësisht në nenet 82 dhe 84 të ligjit 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar.

Një problem tjetër lidhet me mospërcaktimin e kuotave vjetore për hyrjen e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë. Megjithatë neni 82 i ligjit 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, përcakton detyrimin e miratimit të kuotave vjetore cdo vit nga Këshilli i Ministrave, në këtë nen nuk përcaktohet qartë mënyra e hartimit të tyre dhe tipologjia e analizave të fuqisë punëtore për të cilën ka nevojë tregu i punës në vend, që duhet të merret në konsideratë në përcaktimin e tyre.

Problem tjetër që shqyrtohet është kufizimi për të mos lëshuar leje pune për shtetasit e huaj kur numri i shtetasve të huaj tejkalon 10% të punonjësve të punësuar në një subjekt. Duke qenë se ka subjekte të cilat për vetë tipologjinë e shërbimeve që ofrojnë kanë nevojë për më shumë fuqi punëtore të huaj se subjekte të tjera, si dhe duke qenë se ligji 108/2013 “Për të huajt”, parashikon instrumenta të tjerë që garantojnë vetëm hyrjen në tregun e punës në vend të fuqisë punëtore të huaj që kërkon tregu i punës (parimi i vendosjes së kuotave, parimi preferencial), kufizimi i 10 % vlerësohet i panevojshëm dhe vetëm shton pengesat administrative për plotësimin e nevojave për fuqi punëtore të tregut vendas të punës.

Gjithashtu, në kuadër të ndryshimeve të propozuara për të krijuar lehtësira për shtetasit e huaj të pajisen me vizë, të punësohen është vlerësuar edhe lehtësimi dhe shkurtimi i afateve brenda të cilave shqyrtohet leja e qëndrimit apo kërkesa për ripërtëritjen e saj.

Kjo ndërhyrje e qeverisë, është e nevojshme për shkak të kapaciteteve aktuale të misionëve diplomatike, apo posteve konsullore jashtë vendit, të cilat nuk mbulojnë me shërbime të tilla, si: lëshimi i vizave, të gjitha shtetet, shtetasit e të cilëve kërkojnë të vizitojnë Shqipërinë.

Gjithashtu kjo ndërhyrje është bërë e domosdoshme në kushtet kur kemi një rritje të numrit të kërkesave të shtetasve që duan të vizitojnë Shqipërinë apo për t’u dhënë mundësi të punësohen në vendin tonë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesorë të politikës që propozohet janë:

- o Të reduktojë ndjeshëm kohën e marrjes së shërbimit;
- o Të krijojë lehtësira për shtetasit e huaj që aplikojnë për viza;
- o Të evitojë koston e prodhimit të vizave sticker;
- o Të shkurtojë procedurat për dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm, pasi gjithçka do të jetë online dhe e aksesueshme nga të gjitha strukturat për trajtimin e vizave;
- o Të ndikojë pozitivisht në rritjen e numrit të vizitorëve dhe turistëve;
- o Të krijojë lehtësi dhe transparencë për të gjitha strukturat e përfshira në këtë proces;
- o Reduktimi i afateve kohore nga 60 ditë në 10 ditë për aplikimin dhe shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e lejes pune;
- o Plotësimi i nevojave për fuqi punëtore të huaj që paraqesin punëdhënësit në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar në të njëjtën kohë parimin preferencial për mbrojtjen e fuqisë punëtore

vendase

- o Përmirësimin e legjislacionit lidhur me mënyrën e përcaktimit të rasteve kur lejet e punës lëshohen në tejkalim të kuotës 10 % të numrit të punonjësve të punësuar nga punëdhënësi.
- o Të integrojë të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar të RSH-së në këtë proces si një tjetër element shtesë për sigurinë, në zbatimin dhe lëshimin e vizës elektronike online.
- o Lëshimi i vizës elektronike për vizat e tipit “C” dhe “D”, për të njëjtat motive që lëshohet viza pullë për këto tipe vizash;
- o Lëshimi i lejeve të punës dhe qartësimi i procedurës së punësimit në RSh;
- o Shkurtimi i periudhës së shqyrtimit të kërkesës për lëshimin e lejes së qëndrimit.

Me vënien në zbatim të kësaj politike, sistemi e-viza do të përshpejtojë procedurat për pajisjen me vizë të të huajve për të hyrë dhe qëndruar në RSh, duke ofruar një proces të kompletuar elektronik që nga aplikimi dhe deri tek lëshimi i vizës elektronike, duke mundësuar kështu integrimin e të gjitha institucioneve që janë përgjegjëse për procesin e verifikimit dhe miratimit të vizave, do të përshpejtohen afatet për t'u pajisur me leje pune dhe leje qëndrimi.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e kësaj politike është marrë në shqyrtim situata aktuale e pajisjes me vizë të shtetasve të huaj, numri aktual i misioneve diplomatike, posteve konsullore që lëshojnë viza për të hyrë në Republikën e Shqipërisë, mundësia financiare për shtimin e tyre, si dhe rritja e interesave kombëtare për zhvillimin ekonomik, lehtësimi në politikën e qëndrimit të lidhur me afatin e shqyrtimit të kërkesës për leje qëndrimi, duke lehtësuar politikën e punësimit për disa kategori shtetasish të huaj, si dhe duke shkurtuar afatet dhe procedurat për pajisjen me leje pune.

Për realizimin e kësaj politike janë marrë në konsideratë këto tre opsione:

Opsioni bazë/status quo - Të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues, konkretisht me ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, duke shtuar numrin e përfaqësive diplomatike jashtë vendit, apo lidhur marrëveshje dy ose shumëpalëshe me vende të tjera, për paraqitjen e aplikantit për vizë në përfaqësinë përkatëse të këtyre vendeve;

Opsioni 1 - Ndryshimi i ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar,

Opsioni 2 - Hartimi i një projektligji të ri “Për të huajt”.

Nga krahasimi i opsioneve të mësipërme për realizimin e politikës që parë në optikën e avantazheve/disavantazheve rezulton:

1. Opsioni bazë/status quo nuk kërkon ndërhyrjen e qeverisë, por do të ndeshë në vështirësi përsa i takon kohës që do të marrë dhe zbatimin në praktikë të tij. Vetë ligji për të huajt në nenin 25, pika 1, parashikon rastet e lëshimit të vizave nga përfaqësitë me të cilat shteti shqiptar ka lidhur marrëveshje, por për lidhjen e këtyre marrëveshjeve duhet të ekzistojë vullneti dhe interesi i të dy palëve.
2. Zbatimi i opsionit 1, ndryshimi i ligjit për të huajt, është opsioni i preferuar pasi nëpërmjet këtij opsioni realizohet edhe synimi i lehtësimit të procedurave në lidhje me lëshimin e vizës elektronike, shkurtimi i afateve të lëshimit të lejes së punës dhe i afatit brenda të cilit do të shyrtohet kërkesa për lejen e qëndrimit apo kërkesa për ripërtëritjen e saj.
3. Zbatimi i opsionit 2, që konsiston në hartimin e një ligji të ri për të huajt nuk konsiderohet si opsion i preferuar pasi nga njëra anë do të merrte shumë kohë hartimi i një projektligji të ri për të huajt dhe nuk do të mund të siguronte lehtësimin e procedurave për pajisjen me vizë elektronike, shkurtimin e afateve për pajisjen me leje pune apo të afateve për shqyrtimin e kërkesës për leje

qendrimi. Nga anat tjetër dispoziat që parashikohet të ndryshohen janë më pak se 1/3 e ligjit ekzistues dhe kjo nuk do të justifikonte bërjen e një ligji të ri.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Me opsionin 1, të cilin e vlerësojmë si opsioni i preferuar synohet rregullimi ligjor për të mundësuar shtetasit e huaj të mund të aplikojnë për vizën e tipit “C” dhe “D” ne menyre elektronike, nepermjet sistemit elektronik online te vizave.

Aplikimi i vizës online do të reduktojë ndjeshëm kohën e marrjes së shërbimit, do të ketë shumë më pak kosto në aspektin e burimeve njërezore që do të përfshihen në procesin e ofrimit të shërbimit, do të krijojë lehtësi për shtetasit e huaj që aplikojnë për viza, si dhe do të reduktojë kostot e prodhimit të vizave sticker, do të shkurtojë procedurat për dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm, pasi gjithçka do të jetë online dhe e aksesueshme nga të gjitha strukturat për trajtimin e vizave.

Kostimi për realizimin e kësaj politike në këtë fazë mund të trajtohet vetëm në terma të përgjithshëm, kjo për shkak se analiza e këtij impakti kufizohet me daljen e akteve nënligjore që lidhet me përcaktimin e formatit të vizës elektronike.

Sa i përket impaktit social të kësaj politike, kjo lidhet me respektimin e të drejtës së cdo shtetasi për të lëvizur i lirë. Nga ana tjetër kjo politikë do të ndikojë pozitivisht në rritjen e numrit të vizitorëve dhe turistëve, ndërkohë që vetë procesi do të bëhet me transparent duke qenë që informacioni i nevojshëm për vizën elektronike do të merret dhe aksesohet nga të gjitha institucionet e përfshira në procesin e lëshimit të vizave. Ndërkohë që integrimi i të gjitha Pikave të Kalimit Kufitar të RSH-së në këtë proces është një tjetër element shtesë për sigurinë, në zbatimin dhe lëshimin e vizës elektronike online.

Ne lidhje me lejet e punes:

Në periudhën afatshkurtër: Zbatimi i opsionit të preferuar mund të sjellë shtimin e disa kostove administrative, si për trajnimin e stafit që do shqyrtojë kërkesat dhe lëshimin e lejeve të punës.

Në periudhën afatgjatë: Pritshmëritë janë për shtim të numrit të shtetasve të huaj që punojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për rrjedhojë më shumë të ardhura në buxhetin e shtetit.

Ndikimi mbi bizneset: Bizneset përfitojnë nga zbatimi i opsionit të preferuar duke plotësuar nevojat e kompanisë për fuqi punëtore të huaj dhe realizuar projektet dhe investimet e tyre, çka sjell edhe më shumë fitime për ta.

Ndikimi mbi personat: Zbatimi korrekt i opsionit të preferuar sjell qëndrueshmërinë, progresin e aktivitetit të subjekteve që punësojnë shtetas të huaj dhe rritjen e tyre, duke u shoqëruar edhe me shtimin e vendeve të reja të punës, rritjen e standardeve të fuqisë punëtore vendase nëpërmjet trajnimeve brenda kompanisë por dhe rritjes së konkurrencës.

Ne lidhje me lejet e qendrimit, reduktimi i periudhës për shqyrtimin e kërkeses për leje qendrimi ka ndikim pozitiv mbi shtetasit e huaj, dhe nuk shoqërohet me ndonjë ndikim financiar. Ndikimi lidhet me përshpejtimin e procedurës.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
-----------	-----------	-----------

103 000 000	14 400 000	14 400 000	
Opsioni 1 (I preferuar)- “Ndryshimi i ligjit 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar”” Ajo që vlen për t’u theksuar në përzgjedhjen e opsionit 1 si opsioni i preferuar është se ofrimi i vizës elektronike nuk cenon cilësinë e ofrimit të këtij shërbimi; krijon lehtësi dhe transparencë si për aplikantët dhe për institucionet e përfshira në procesin e lëshimit të vizave; redukton kohën e marrjes së shërbimit si dhe do të ndikojë pozitivisht në rritjen e numrit të vizitorëve dhe turistëve si dhe është një mundësi e mire për të përmbushur brenda një afati kohor të shkurtër, qëllimin për lehtësimin e hyrjes së fuqisë punëtore të huaj të nevojshme për tregun e punës në vend.			
KONSULTIMI <i>Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)</i> Ky projektligj i është nënshtruar procesit të konsultimit publik në Regjistrin Elektronik të Konsultimit Publik (hedhur në datën 19.09.2019).			
ZBATIMI DHE MONITORIMI <i>Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?</i> Politika për ndryshimin e ligjit nr.108/2013, “Për të huajt” i ndryshuar është e zbatueshme menjëherë me miratimin e këtij projektligji, i cili do i hapë rrugë edhe miratimit të aktit nënligjor i cili do të përcaktojë formatin dhe modalitetet e lëshimit të vizës elektronike. Për zbatimin e tij ngarkohen strukturat përkatëse që merren me procesin e lëshimit të vizave, si Ministria e Brendshme, Ministria Për Evropën dhe Punët e Jashtme, SHISH. Gjithashtu projektligji megjithëse redukton afatet e aplikimit dhe shqyrtimit të lejes së punës, nuk ndryshon në thelb procedurën për të zhvilluar aplikimin. Për këtë arsye është i zbatueshëm drejtpërdrejtë pas miratimit të tij nga strukturat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit (Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi). Monitorimi i zbatimit të ligjit do të realizohet nëpërmjet monitorimit të brendshëm të vetë strukturave të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi). Monitorimi në nivel qendror do të realizohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ndryshimi i bere ne lidhje me reduktimin e afatit per shqyrtimin e kerkeses per ripërteritjen e lejes se qendrimi eshte direkt i zbatueshem me hyrjen ne fuqi te ligjit. Ky proces do te zbatohet dhe do te monitorohet nga autoritet pergjegjese per kufirin dhe migracionin.			

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Iniciativa për hartimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.108/2013, “Për të huajt” i ndryshuar, vjen në kuadër të:

- Realizimit të detyrave që kanë institucionet përgjegjëse shqiptare për lëshimin e vizave për të huajt
- Rritjes së numrit të kërkesave për viza për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë
- Mungesa e përfaqësive diplomatike në vendet nga vijnë kërkesat për vizë;
- Reduktimi i afateve për lëshimin e lejes së punës;

- Perjashtimi nga pajisja me leje pune dhe cerifikate regjistrimi ne pune te kategorive te caktuara te shtetasve;
- Reduktimi i afateve per shqyrtimin e lejes se qendrimit dhe te ripërteritjes se saj;

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Aktualisht i huaji, i cili kërkon të hyjë në Republikën e Shqipërisë, pajiset me vizë nga përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit duke e stampuar vizën në dokumentin e udhëtimit.

Lëshimi i vizës bëhet vetëm pasi ka përfunduar procedura e vlerësimit të kërkesës për vizë nga autoritetet përgjegjëse të përcaktuara në ligj dhe procedura e vlerësimit të kërkesës për vizë zgjat jo më shumë se 15 ditë nga data e pranimit të aplikimit për vizë. Në raste përjashtimore, ky afat mund të shtyhet deri në 30 ditë.

Aplikimi për vizë nga i huaji bëhet jo më shumë se 90 ditë përpara datës së planifikuar për të ardhur në Republikën e Shqipërisë, pranë përfaqësive diplomatike dhe/ose konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit dhe duhet të paraqitet personalisht në konsullatë, të paktën kur kryen për herë të parë aplikimin. Pas aplikimit të parë, në rast se e ka të pamundur, aplikuesi përjashtohet nga detyrimi i paraqitjes personale për një periudhë prej 59 muajsh nga aplikimi i parë, me kusht që formulari i aplikimit për vizë të nënshkruhet nga aplikuesi. Në raste të dyshimta, aplikuesit mund t'i rikërkohet paraqitja personale edhe brenda këtij afati.

Në rast se nuk ka përfaqësi diplomatike/ konsullore shqiptare në shtetin e aplikuesit ose në vendin ku ai është banor, i huaji bën kërkesë me postë në përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendin e parashikuar, sipas një liste të miratuar me urdhër të ministrit të Punëve të Jashtme, e cila publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, por edhe kjo kërkon paraqitjen personale të aplikuesit në momentin e marrjes së vizës.

Grupet e prekura janë shtetasit e huaj që vijnë për motive turizmi në Republikën e Shqipërisë; të biznesit; të shërbimit civil; të angazhimeve në organizata të shoqërisë civile, që udhëtojnë për qëllime trajnimesh, edukimi apo që vijnë rregullisht të kontribuojë pranë organizatave ndërkombëtare të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu një tjetër problemi kryesor lidhet me procedurat dhe kohën e gjatë që përcakton ligji aktual 108/2013 “Për të huajt” i ndryshuar, për aplikimin dhe lëshimin e një leje pune. Nevoja për fuqi punëtore të kualifikuar, të cilën nuk e gjejmë në vend, është evidentuar nga punëdhënësit, nëpërmjet analizave (SNA 2017) por edhe nëpërmjet kërkesave për tejkallim të 10%. Nga ana tjetër, legjislacioni në fuqi për të huajt, kërkon që para se të miratohet kërkesa për lëshimin e një leje pune për të paktën 4 javë vendi i punës duhet të qëndrojë i shpalluar dhe më pas përcakton 30 ditë të tjera për të shqyrtuar kërkesën për leje pune. Këto afate të gjata kohore të lidhura me procesin e lëshimit të lejes së punës, bëjnë që të mos plotësohet në kohën e duhur nevoja e punëdhënësit për punësimin e një punonjësi i cili është i domosdoshëm për biznesin e tij. Shumë punëdhënës kanë shprehur shqetësimin për afatet kohore dhe procedurën e tejzgjatur të aplikimit dhe miratimit të një leje pune.

Grupet e prekura nga ky problem janë:

Biznesi- punëdhënësit kërkojnë procedura dhe afate kohore më të shpejta dhe transparente për aplikimin dhe shqyrtimin e një kërkesë për leje pune.

Qytetarët – plotësimi i nevojave për fuqi punëtore sjell rritjen e bizneseve të cilat gjenerojnë vende të reja pune.

Qeveria – Shumë herë fuqia punëtore e huaj ka qenë e nevojshme për realizimin e projekteve madhore të cilat janë me interes kombëtar si dhe për realimin e investimeve të shtetasve të huaj në RSH.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Duke qenë se problemi në shqyrtim është mungesa e një hapsire ligjore që t'i mundësojë shtetasit të huaj, që tashmë e ka një vizë stiker në pasaportë, të vijë e të vizitojë Shqipërinë, pa pasur nevojë të dërgojë edhe njëherë të gjithë dokumentacionin nëpërmjet postës, apo të paraqitet edhe njëherë në përfaqësinë diplomatike të RSH për të marrë vizën, është i pamundur materializimi i tij pa ndërhyrjen e Këshillit të Ministrave, i cili në përputhje me nenin 81, pika 1 të Kushtetutës ka të drejtën e propozimit të ligjeve. Qeveria ka evidentuar si një problem me rëndësi në tregun tonë të punës mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar për plotësimin e nevojave të punëdhënësve. Legjislacioni për të huajt që rregullon procedurat e hyrjes për punësim të shtetasve të huaj në tregun e punës në territorin e Republikës së Shqipërisë (RSH) parashikon procedura dhe afate kohore të tejzgjatura për lëshimin e lejeve të punës për shtetasit e huaj që duan të punojnë në RSH. Nisur nga nevoja e punëdhënësve për plotësimin e nevojave të tyre për fuqi punëtore të huaj në periudhën kohore kur ata kanë nevojë për këtë fuqi punëtore, u vlerësua e nevojshme ndërmarrja e kësaj ndërhyrjeje.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrje synohet të:

- o Krijohen lehtësira për shtetasit e huaj që aplikojnë për viza të tipit “C” dhe “D”;
- o Reduktoje procedurën për dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm për vizë, pasi gjithçka do të jetë online dhe e aksesueshme nga të gjitha strukturat për trajtimin e vizave;
- o Ndikojë pozitivisht në rritjen e numrit të vizitorëve dhe turistëve;
- o Të eliminojë barrierat e panevojshme administrative për plotësimin e kërkesës për kualifikime që kërkon tregu i punës dhe kërkesës së punëdhënësve për punëtorë të huaj. Qeveria për adresimin e kësaj politike do të ndërhyjë duke propozuar ligjin për “Ndryshimit të ligji nr. 108/2013 “Për të huajt”.

Ndaj qeveria duke plotësuar këtë projektligj synon të rregullojë si duhet procedurat në fushën e punësimit të të huajve, duke iu përgjigjur kësaj kërkesave të punëdhënësve vendas e të huaj.

Kjo ndërhyrje e qeverisë është e parashikuar në dokumentet politike të miratuara më përpara nga ajo, sic janë Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 dhe plani i saj i veprimit, si dhe Plan i Kombëtare për Integrimi Evropian 2019-2021, e në ndër të tjera e më konkretisht miratimi i këtij projektligji të ri përmbush objektivat e nivelit të lartë të qeverisë në fushën e punësimit.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat e propozimit janë:

- o Të reduktojë ndjeshëm kohën e marrjes së shërbimit;

- o Të krijojë lehtësira për shtetasit e huaj që aplikojnë për viza;
- o Të evitojë koston e prodhimit të vizave sticker;
- o Të shkurtojë procedurat për dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm, pasi gjithçka do të jetë online dhe e aksesueshme nga të gjitha strukturat për trajtimin e vizave;
- o Të ndikojë pozitivisht në rritjen e numrit të vizitorëve dhe turistëve;
- o Të krijojë lehtësi dhe transparencë për të gjitha strukturat e përfshira në këtë proces;
- o Reduktimi i afateve kohore nga 60 ditë në 10 ditë për aplikimin dhe shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e lejes pune;
- o Plotësimi i nevojave për fuqi punëtore të huaj që paraqesin punëdhënësit në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar në të njëjtën kohë parimin preferencial për mbrojtjen e fuqisë punëtore vendase
- o Përmirësimin e legjislacionit lidhur me mënyrën e përcaktimit të rasteve kur lejet e punës lëshohen në tejkalim të kuotës 10 % të numrit të punonjësve të punësuar nga punëdhënësi.
- o Të integrojë të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar të RSH-së në këtë proces si një tjetër element shtesë për sigurinë, në zbatimin dhe lëshimin e vizës elektronike online.
- o Lëshimi i vizës elektronike për vizat e tipit “C” dhe “D”, për të njëjtat motive që lëshohet viza pullë për këto tipe vizash;
- o Lëshimi i lejeve të punës dhe qartësimi i procedurës së punësimit në RSh;
- o Shkurtimi i periudhës së shqyrtimit të kërkesës për lëshimin e lejes së qëndrimit.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni 0 (status quo); Pra vijimi i qjendjes ekzistuese, duke mbajtur në fuqi ligjin 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, do të vazhdojë situata aktuale, konkretisht, punëdhënësit do duhet të presin deri në 60 ditë për të marrë një leje pune për punonjës me shtetësi të huaj që duan të punojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto afate bëhen shumë të tejzgjatura duke marrë në konsideratë dhe afatet kohore për të aplikuar dhe për tu pajisur më pas me lejen përkatëse të qëndrimit. Kjo situatë sjell si pasojë mos plotësimin e nevojës për punonjës të huaj në periudhën kur punëdhënësi ka nevojë duke ndikuar edhe në ecurinë e punës së kompanisë apo biznesit.

Opsioni 2 (i preferuar) - Ndryshimi i ligjit ekzistues për të huajt, përmirëson legjislacionin për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë, duke reduktuar pengesat e panevojshme për punësimin e tyre, nëpërmjet shkurtimit të afateve kohore dhe lehtësimit të procedurave për t’u pajisur me leje pune. Gjithashtu përmirëson dhe bën të zbatueshme dispozitat e ligjit për të huajt që i referohen kuotave vjetore për hyrjen për punësim të të huajve në vend, si dhe realizon përafrim të pjesshëm me legjislacionin europian në fushën e levizjes së lirë të punonjësve.

Opsioni 3 - miratimi i një ligji të ri për të huajt. Objektivat që synon të realizojë ndërhyrja e qeverisë e parashikuar në opsionin 1 (të preferuar) si dhe problemi që synon të trajtojë janë të realizueshme nëpërmjet amendimit të ligjit ekzistues për të huajt dhe e bën të panevojshme për realizimin e tyre hartimin e një ligji të ri për të huajt.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*

- Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.
 - Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).
 - Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.
 - Diskutoni kufizimin e analizës:
 - Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.
 - Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.
 - Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.
 - Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:
 - Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.
 - Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.
 - Paraqisni përllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).

Kjo politikë do të synojë të:

Reduktojë ndjeshëm kohën e marrjes së shërbimit. Reduktimi i kohës së marrjes së shërbimit konsiston në faktin se shtetasit e interesuar për t'u pajisur me vizën pullë mund të aplikojë online për vizë elektronike, pa qenë të detyruar për t'u paraqitur fizikisht në përfaqësinë që mbulon shtetin nga ai vjen. Nisur nga sa më sipër, këta shtetas, marrin shërbimit e dëshiruar në një kohë më të shkurtër (shkurtohet koha që do t'i merrte për të shkuar nga shteti ku jeton në shtetin ku vendi ynë ka përfaqësi diplomatike) dhe me më pak shpenzime (do të paguajë vetëm për udhëtimin për të ardhur në Shqipëri).

Krijojë lehtësira për shtetasit e huaj që aplikojnë për viza. Viza elektronike do të krijojë lehtësira për shtetasit e huaj që aplikojnë për viza, përsa i përket **kohës, kostove dhe mundësisë së marrjes së informacionit online me anë të sistemit.**

Me vënien në funksionimi të sistemit e-visa, shtetasit e interesuar, përjashtohen nga detyrimi për tu paraqitur fizikisht në përfaqësinë e RSh-së për të tërhequr vizën e miratuar.

Evitojë koston e prodhimit të vizave sticker. Evitimi i koston së prodhimit të vizave sticker, konsiston në faktin se shteti do të ulën koston e prodhimit të vizave sticker. Qytetari pajiset me vizë elektronike e cila gjenerohet dhe dërgohet në emailin e aplikantit si e- Visa. Parashikohet që me vënien në aplikim të këtij sistemi të kursehen rreth 3000 pulla sticker në vit.

Shkurtojë procedurat për dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm. Nisur nga fakti që procedura e aplikimit do të kryhet online, duke ngarkuar në sistem të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, nuk do të jetë e nevojshme paraqitja në përfaqësi me dokumentacionin fizik.

Ndikoje pozitivisht në rritjen e numrit të vizitorëve dhe turistëve.

Krijojë lehtësi dhe transparencë për të gjitha strukturat e përfshira në këtë proces;

Të integrojë të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar të RSh-së në këtë proces si një tjetër element shtesë për sigurinë, në zbatimin dhe lëshimin e vizës elektronike online. Nisur nga kërkesa për çështjen e sigurisë gjatë këtij procesi, të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar të RSh-së (24 të tilla), do të jenë të përfshira në këtë proces.

Reduktimi i afateve kohore nga 30 ditë në 10 ditë për aplikimin dhe shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e lejes pune;

Plotësimi i nevojave për fuqi punëtore të huaj që paraqesin punëdhënësit në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar në të njëjtën kohë parimin preferencial për mbrojtjen e fuqisë punëtore vendase;

Përmirësimin e legjislacionit lidhur me mënyrën e përcaktimit të rasteve kur lejet e punës lëshohen në tejkalim të kuotës 10 % të numrit të punonjësve të punësuar nga punëdhënësi.

Reduktimin e afateve kohore brenda të cilit autoritetet përgjegjëse të kufirit dhe migracionit shqyrtojnë kërkesën për pajisjen ose ripërtëritjen e lejes së qëndrimit, nga 60 ditë në 30 ditë.

Nga projektligji ri preken tre grupe interesi: biznesi, qytetarët dhe qeveria/ sektori publik.

Biznesi:

- ndikime të drejtëpërdrejta:

- 1) Mundësi plotësimi të vendeve të punës me fuqi punëtore të kualifikuar sipas nevojave të tyre;
- 2) Realizimi brenda afateve të përcaktuara i projekteve dhe investimeve të tyre, cka sjell edhe më shumë fitime për ta.

- ndikime jo të drejtëpërdrejta:

- 1) Infrastrukturë publike më e mirë;
- 2) Më shumë investime dhe shërbime publike të financuara nga buxheti i Shtetit;

Qytetarët:

- ndikime të drejtëpërdrejta:

- 1) Mundësi të shtuara punësimi;
- 2) Mundësi trajnimi dhe kualifikimi në punë;

- Ndikime jo të drejtëpërdrejta

- 1) Infrastrukturë publike më e mirë;
- 2) Më shumë investime dhe shërbime publike të financuara nga buxheti i Shtetit;

Qeveria/ sektori publik:

- ndikime të drejtëpërdrejta:

- 1) Më shumë të hyra në buxhetin e Shtetit;
- 2) Pakësimi shpenzimeve për pagesën e asistencës sociale;
- 3) Rritje ekonomike;

- ndikime jo të drejtëpërdrejta:

- 1) Rritja e mirëqënies ekonomike të qytetarëve;

Biznesi- Ndikimet për biznesin janë të drejtëpërdrejta, duke qenë se nëpërmjet procedurave më të thjeshta të punësimit ata arrijnë të plotësojnë kërkesën e tyre për fuqi punëtore të huaj për kualifikime të cilat nuk arrijnë ti gjejnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu thjeshtëzimi i procedurave bën që ato të jenë më transparente dhe të reduktojnë në maksimum mundësitë për abuzim gjatë procesit të shqyrtimit dhe lëshimit të lejeve të punës. Plotësimi i vendeve të punës me punonjës të cilat nuk arrijnë kualifikimet për të cilat një ndërmarrje ka nevojë bën që të kemi realizim të projekteve të saj si dhe shtim të fitimeve dhe gjenerim të vendeve të reja të punës. Nuk mund të përlogariten në këtë fazë se sa do të jetë ky ndikim i drejtëpërdrejtë nga ana sasiore, për është me rëndësi për biznesin të plotësojë nevojat për fuqi punëtore të kualifikuar duke garantuar kështu vijimësinë e punës për investimin e tij si dhe duke pakësuar kohën dhe kostot sociale për këtë.

Qytetarët – Nga kjo ndërhyrje pritet që klima e biznesit të jetë shumë pozitive duke ndihmuar bizneset të kenë sukses në sipërmarrjen e tyre, dhe duke sjellë rritjen e tyre si dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës. Krijimi i kushteve për rritjen e biznesit krijon dhe mundësi për rritjen e standardeve të fuqisë punëtore vendase nëpërmjet trajnimeve brenda kompanisë por dhe rritjes së konkurrencës brenda punonjësve të saj. Nuk mund të llogaritet në këtë fazë ky ndikim nga ana sasiore.

Qeveria/ sektori publik: Krijimi i kushteve për suksesin e bizneseve në vend sjell më shumë të hyra në buxhetin e Shtetit, si nga zëri tatime taksa, edhe për sigurime shoqërore e shëndetësore, etj. Po ashtu duke qenë se shoqërohet me hapjen e vendeve të reja të punës, shumë njerëz do të dalin nga skema e ndihmës sociale dhe do të jenë në grupin e të punësuarve, duke pakësuar shpenzimin buxhetor për ndihmën sociale e duke u kthyer ata në kontribues në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Nga ana sasiore është e pamundur llogaritja në këtë fazë.

Ky projektligj ka kosto në buxhetin e shtetit, të cilat do të mbulohen nga buxheti i ministrive respektive dhe i institucionit përgjegjës për mirëmbajtjen e sistemit.

Ndikimi mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme: Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme do të jenë përfitues të drejtpërdrejtë të kësaj ndërhyrjeje si dhe pjesa tjetër e biznesit.

Supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet janë:

- 1) Ekzistencën e një kuadri rregullator dhe një klime pozitive për biznesin si dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që nxit zhvillimin e këtyre sipërmarrjeve;
- 2) Ekzistenca e një kuadri rregullator në fushën e punësimit dhe migrimit të punës që pengon mundësinë e abuzimit me fuqinë punëtore në vend.

Supozimet e mësipërme bazohen në komunikimin me përfaqësues të bizneseve, sipërmarrjeve dhe punëdhënës të ndryshëm si dhe në analiza të legjislacionit për të huajt dhe analiza të nevojave për aftësi në vend.

Risqet më të mëdha për të penguar realizimin e përfitimeve/ pritshmërive pas miratimit të projektligjit të ri “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar”, janë si vijojnë:

- 1) Moszbatimi korrekt i ligjit nga subjektet e detyruara (institucionet publike);

Një politikë jo favorizuese për biznesin, sipërmarrjen dhe punëdhënësit që nuk krijon mundësinë e suksesit të tyre.

NR.	BIZNESI	QYTETARËT	QEVERIA
<i>A/ Ndikime të drejtëpërdrejta</i>			
1.	Mundësi plotësimi të vendeve të punës me fuqi punëtore të kualifikuar sipas nevojave të tyre	Mundësi të shtuara punësimi	Rritje e të hyrave në buxhetin e Shtetit
2.	Realizimi brenda afateve të përcaktuara i projekteve dhe investimeve të tyre, cka sjell edhe më shumë fitime për ta.	Mundësi trajnimi dhe kualifikimi në punë	Pakësim i shpenzimeve për ndihmën sociale
<i>B/ Ndikime jo të drejtëpërdrejta</i>			

1.	Infrastrukturë publike më e mirë	Infrastrukturë publike më e mirë	Rritja e mirëqënies ekonomike të qytetarëve;
2.	Më shumë investime dhe shërbime publike të financuara nga buxheti i Shtetit	Më shumë investime dhe shërbime publike të financuara nga buxheti i Shtetit	

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni i preferuar është opsioni 1, i cili i korrespondon propozimit të ligjit për ndryshimin e ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt. Ky ndryshim do të krijoj lehtësi dhe transparencë si për aplikantët dhe për institucionet e përfshira në procesin e lëshimit të vizave, redukton kohën e marrjes së shërbimit si dhe do të ndikojë pozitivisht në rritjen e numrit të vizitorëve dhe turistëve; Të gjitha institucionet e shtetit shqiptar përgjegjëse për trajtimin e procedurës së vizës, Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit si dhe Shërbimi Informativ Shtetëror do të jenë njëloj të përfshira si për vizat stickers; Informacioni i nevojshëm për vizën elektronike do të merret dhe aksesohet nga të gjitha institucionet e sipërpërmendura.

Opsioni 1, ndryshimi i ligjit ekzistues për të huajt ka qenë i preferuari për të zgjidhur problemin e krijuar nga vonesat në shqyrtimin e aplikimeve për leje pune për punësimin e shtetasve të huaj. Këto vonesa vijnë si rrjedhim i vetë përcaktimeve të afateve kohore që bën ligji por edhe si rezultat i procedurave të tejzgjatura për miratimin e një leje pune përcaktuar gjithashtu në ligj. Arsyeja për zgjedhjen e këtij opsioni është se problemi i krijuar mund të zgjidhet nëpërmjet amendimit të disa neneve të ligjit ekzistues për të huajt.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e opsionit të preferuar janë: Ministria përgjegjëse për migracionin e punës (Ministria e Financave dhe Ekonomisë), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Brendshme.

Në nivel rajonal dhe vendor përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji do të jenë Shërbimi Kombëtar i Punësimit (Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi) dhe strukturat në varësi të tij.

Nuk parashikohen pengesa të mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur, pasi strukturat përgjegjëse do të bazohen në kriteret dhe procedurën e përcaktuar qartazi në ligj dhe aktet nënligjore në fuqi.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.
- Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

Në këtë fazë të zhvillimit të VN, nuk mund të planifikojmë dot masat e monitorimit dhe të vlerësimit apo të identifikojmë kriteret/treguesit për të matur arritjen ose progresin drejt tyre.

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë me qëllim monitorimin dhe zbatimin e opsionit të preferuar do të

- (i) hartojë raporte periodike të paktën 1 vjecare për punësimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, numrin e lejeve të punës të lëshuara sipas llojit të aktivitetit si dhe problematikën e hasur gjatë zbatimit të legjislacionit që rregullon punësimin e të huajve në vend.
- (ii) Ushtrorë kontrole tek Shërbimi Kombëtar i Punësimit (Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi) dhe strukturat në varësi të tij në lidhje me zbatimin e ligjit për të huajt;
- (iii) Komunikojë në mënyrë të vazhdueshme me komunitetin e biznesit dhe do të mbledhë prej tyre mendime, ankesa, sugjerime dhe propozime në kuadrin e zbatimit të ligjit për të huajt dhe do të marrë masat e përshtatshme për të rivendosur ligjshmërinë, kur konstatohen shkelje.

Treguesit bazë për të matur arritjen e qëllimeve janë përmbushja e hapave/ masave të renditura më lart, si dhe kontrolli periodik e i pandërprerë i zbatimit të këtij ligji, dhe akteve nënligjore, si dhe ndjekja e statistikave të lartpërkshkruara për të kuptuar përmbushjen e objektivave të vëna, që në fillim të hartimit të këtij ligji.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Efektet e plota financiare të ndikimeve të këtij projektligji janë të pamunduara të vlerësohen pasi gjithcka varet nga numri i shtetasve të huaj që mund të vijnë në Shqipëri, mbështetur në kuadrin e ri favorizues që krijon ky projektakt. Ky numër është i pamundur të parashikohet si rezultat dhe kuantifikimi i ndikimeve mbetet i vështirë për tu bërë.

	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
Faktori zbritës	1.000000	0.952835	0.907894	0.865073	0.824271	0.785394	0.748351	0.713055	0.679423	0.647378
Kosto për buxhetin – një herë (Kosto e ngritjes së sistemit)	89.4									
Kosto për buxhetin – në vazhdim (Mirëmbajtje sistemi)	14.4	14.4	14.4	14.4						
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në										

vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	103.8	14.4	14.4	14.4						
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	103.8	13.7	13.1	12.5						
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total	- 143.1									
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	- 143.1									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	143.1	-	- 143.1
Opsioni 2	143.1	-	- 143.1

Shënim: Vlerat në tabelat e shtojcave 2a dhe 2b janë pa TVSH.

Duke qënë se të dy opsionet kanë vlerë të njëjtë, opsioni i preferuar është opsioni 1 i cili i korrespondon propozimit të ligjit për ndryshimin e ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt” për arsye se problemi i krijuar mund të zgjidhet nëpërmjet amendimit të disa neneve të ligjit ekzistues për të huajt, pa qënë e nevojshme për hartimin e një ligji të ri.